



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 142, datë 28.09.2023

PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË
BASHKIAKE DURRËS

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, e nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të Ligjit nr.35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; Ligjit nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023, si dhe projektbuxhetin Afat Mesëm 2023-2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake të Bashkisë së Durrësit, si më poshtë vijon:



Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Paga për pozicion
1	Drejtor Drejtorie	II-b	91 000
2	Përgjegjës Sektori	III-a	80 300
3	Specialist	III-b	70 000
4	Inspektor i Policisë Bashkiake	-	67 300
5	Punonjës i Policisë Bashkiake	-	61 000

- Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar, për numrat rendorë 1,2 dhe 3 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit
- Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar për numrat rendorë 4 dhe 5 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.
- Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome është si më poshtë vijon:

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i shkencave. Master i arteve. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000 lekë
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000 lekë
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000 lekë

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Tetor 2023 dhe do të përballohen nga fondet e lira të krijuara si pasojë e vakancave të vitit 2023, si dhe nga fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë strukturën dhe organikën e Policisë Bashkiake të Bashkisë Durrës.
4. Çdo rregullim, në aktet e tjera, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.


5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Policisë Bashkiake, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.




KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 628/5 Prot.

Durrës, më 05.10.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.142 datë 28.09.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të policisë Bashkiake Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

